

fq. 2 Kuvendi i Shqipërisë miraton rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014”

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2015 fq. 2
- » Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2015 fq. 3
- » Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31 mars 2015 fq. 4

ZHVILLIME TË TJERA

- » Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave fq. 6
- » AMF prezanton projektin: "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve" fq. 7
- » Zhvillohet takimi i përvitshëm midis AMF dhe FMA të Austrisë, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve fq. 7
- » Mbledhjet e grupeve të punës të IAIS fq. 8
- » Seminar “Mbikëqyrja e grupeve dhe kolegjet e mbikëqyrësve” fq. 9
- » Takimi i nëntë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore fq. 10

LAJMET NGA RAJONI

- » Estoni fq. 11
- » Mali i Zi fq. 11
- » Kosovë fq. 12
- » Kroaci fq. 12

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Kuvendi i Shqipërisë miraton rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014”

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën e mbajtur më 14 maj 2015, ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014”.

Kjo rezolutë vjen pas paraqitjes nga Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, më 27 prill 2015, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, të Raportit “Mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2014”.

Tekstin e plotë të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë e lexoni në linkun e poshtë shënuar.

<http://www.amf.gov.al/files/File/Kuvendi%20Rezoluta%20AMF%202015.pdf>

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-prill 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 17.09% gjatë periudhës janar-prill 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 4.10 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 10.51% duke arritur në 310,905 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 22.53% në krahasim me periudhën janar-prill 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.71 miliardë lekë, apo 71.06% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 21.16% gjatë periudhës janar-prill 2015, krahasuar me periudhën janar-prill 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.38 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2015, duke shënuar një rritje prej 31.01% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbënte 58.09% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 15.11% të tregut të Jo-Jetës;
- sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.98% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 12.25% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila zinte 65.96% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-prill 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 31 mars 2015

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.03.2015 tregon një total asetesh neto prej 685.19 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 56.05 milionë lekë (8.91%) krahasuar me fundin e vitit 2014. E shprehur në euro, totali i asetëve neto është 4.88 milionë euro.

(Sipas kursit zyrtar të këmbimit më 31.03.2015 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 140.34 lekë, www.bankofalbania.org)

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 31.03.2015 ishte 9,715 anëtarë duke shënuar rritje prej 14.42% krahasuar me fundin e vitit 2014.


Tregues të fondeve të pensioneve

<i>Përshkrimi</i>	<i>Vlera (mln. lekë)</i>		<i>Ndryshimi (Në %)</i>
	<i>31.12.'14</i>	<i>31.03.'15</i>	
Asetet neto të FP	629.15	685.19	8.91


Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

<i>Fond Pensioni</i>	<i>31.03.2015</i>	
	<i>Numri i anëtarëve në FP</i>	<i>Asete Neto (mln. lekë)</i>
SIGAL	4,920	340.18
RAIFFEISEN	2,540	252.79
SICRED PENSION	2,255	92.22
TOTAL	9,715	685.19

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 31.03.2015 (Në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve,
31.03.2015 (Në %)



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31 mars 2015

Gjatë tremujorit të parë 2015, në tregun e Fondeve të Investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve "Raiffeisen Prestigj" dhe Fondi i Investimeve "Raiffeisen Invest Euro".

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve në 31.03.2015, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti mbi 65.76 miliardë lekë, me një rritje prej 3.17% krahasuar me 31.12.2014.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilët përbëjnë 75.36% të aseteve të fondeve, me rritje prej 1.67% krahasuar me 31.12.2014.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 31.03.2015 ishte 33,000.

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave



Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së dhe Z. Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi më datë 8 maj 2015, një marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP). Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rritja e bashkëpunimit nëpërmjet institucioneve në shkëmbimin e informacionit, kryerjes së inspektimeve dhe trajnimeve të përbashkëta, në funksion të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose aktiviteteve të lidhura me to, si dhe rritjen e rolit mbikëqyrës, me qëllim forcimin e sistemit parandalues në vend.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, ndër të tjera theksoi se: “Sot ne po formalizojmë një bashkëpunim të nisur vite më parë dhe shumë të efektshëm, në drejtim të përmbushjes së standardeve evropiane në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje përmbush një detyrim ligjor, të cituar edhe në ligjin e sigurimeve dhe risigurimeve, i miratuar në korrik të vitit 2014. Marrëveshja institucionalizon njëkohësisht bashkëpunimin midis dy institucioneve, si dhe i shërben rritjes së rolit mbikëqyrës, me qëllim forcimin e sistemit parandalues në vend”.

Z. Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave, ndër të tjera tha: “Shpreh bindjen se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi mes dy institucioneve tona përbën një hap të mëtejshëm në përpjekjet tona të përbashkëta për rritjen dhe konsolidimin e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve të ligjit, shkëmbimin e informacionit, trajnimet dhe inspektimet e përbashkëta dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

AMF prezanton projektin: "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve"



Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së gjatë prezantimit të projektit

Ceremonia e prezantimit të projektit u zhvillua në datën 6 maj 2015, në praninë e përfaqësuesve të Bankës Botërore, Ambasadës Zvicerane dhe grupeve të tjera të interesit. Me këtë rast, Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, mbajti fjalën e hapjes, e cila u shoqërua nga fjalimet përshëndetëse të Z. Holger Tausch, Zëvendës Shef i Misionit të Ambasadës së Zvicrës dhe Z. Michael Edwards, ekspert i lartë i sektorit financiar të Bankës Botërore.

Projekti pritet të fillojë në verën e këtij viti dhe të zbatohet në një periudhë 36-mujore.

Për të lexuar më shumë klikoni linkun

<http://www.amf.gov.al/files/File/SECO%20projekt%206%20maj%202015%281%29.pdf>

Zhvillohet takimi i përvitshëm midis AMF dhe FMA të Austrisë, për mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve



Përfaqësues të AMF dhe FMA të Austrisë



Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së dhe drejtues të tjerë të AMF-së, gjatë takimit me përfaqësues të FMA të Austrisë

Në vijim të bashkëpunimit për çështjet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), një delegacion nga ky institucion zhvilloi takime në datat 19-20 maj në Tiranë. Delegacioni kryesohej nga Z. Peter Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit.

Z. Braumüller, Drejtor Ekzekutiv në FMA, në takimet e punës që zhvilloi me Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive, ekspertët e AMF-së, si dhe me Bordin e AMF-së diskutoi çështje të rëndësishme të interesit të përbashkët. Ndërmjet të tjerash, takimet u përqendruan në zhvillimet kryesore në tregjet e sigurimeve të Austrisë dhe Shqipërisë gjatë vitit 2014, sidomos të shoqërive austriake të pranishme në Shqipëri; ndryshimet strukturore të të dy autoriteteve mbikëqyrëse; zhvillimet ligjore, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e grupeve dhe çështjet e sekretit profesional.

Prej vitit 2009, të dy institucionet kanë një marrëveshje mirëkuptimi, e lidhur menjëherë pas investimeve të grupeve austriake të sigurimeve në Shqipëri. Prej vitit 2013 AMF është pjesëmarrëse e rregullt e kolegjeve mbikëqyrëse për grupet austriake që operojnë në Shqipëri, duke konkretizuar shkëmbimin e përvojës dhe punën e përbashkët në mbikëqyrjen në sigurime.

Mbledhjet e grupeve të punës të IAIS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) organizoi në datat 11-14 maj mbledhjet e grupeve të punës mbi sjelljen në treg të operatorëve dhe mbi qeverisjen. (*Market Conduct Working Group* dhe *Governance Working Group*). Mbledhjet u zhvilluan në Washington DC, SHBA të organizuara nga IAIS në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimeve (*National Association of Insurance Commissioners, NAIC*). NAIC është organizata e rregullatorëve të sigurimeve e shteteve të Amerikës. Kjo organizatë bashkëpunon ngushtë me IAIS-in e organizmat e tjerë të fushës financiare për vendosjen e standardeve ndërkombëtare financiare në sektorin e sigurimeve.

Temat kryesore lidheshin me:

- » Sjelljen ndaj riskut në biznes;
- » Diskutimin e disa prej Parimeve Bazë në Sigurime të IAIS-it (*Insurance Core principles, ICP*)
- » Qeverisjen e grupeve të sigurimeve.

Anëtarët pjesëmarrës bënë një paraqitje të zhvillimeve të fundit legjislativ të vendeve respektive. Në mbledhjet e radhës së grupeve të punës u diskutua ndër të tjera edhe lidhur me problemet e mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, si edhe zhvillimet e mekanizmave rregullatorë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Mbledhjet i shërbejnë shkëmbimit të pikëpamjeve dhe risive në tregun e sigurimeve, veçanërisht në kushtet e reja financiare globale për mbikëqyrje efektive të tregut.

Seminar “Mbikëqyrja e grupeve dhe kolegjet e mbikëqyrësve”

Në datat 7-8 maj 2015 në Berlin, Gjermani, u zhvillua seminari ndërsektorial “Mbikëqyrja e grupeve dhe kolegjet e mbikëqyrësve”. Ky seminar organizohej nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*) në bashkëpunim me Autoritetin Evropian të Tregjeve të Letrave me Vlerë (*ESMA*), Autoritetin Evropian Bankar (*EBA*) si dhe Komitetin Evropian të Autoriteteve Mbikëqyrëse (*Joint Committee of the European Supervisory Authority*). Krahas përfaqësuesve dhe ekspertëve nga autoritetet organizatore, moderatorë dhe lektorë në seanca të ndryshme ishin edhe ekspertë në çështjen e kolegjeve mbikëqyrëse nga autoritetet rregullatore të Holandës, Gjermanisë dhe Suedisë.

Seminari synoi promovimin e zhvillimit të një kulture të përbashkët mbikëqyrëse edhe përmes të mësuarit, diskutimit dhe shkëmbimit të informacionit rreth praktikave mbikëqyrëse.

Ndër temat kryesore në seminar ishin:

- » Kuadri ligjor rregullues për bashkëpunimin mes mbikëqyrësve;
- » Sfidat në shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit nga kolegje mbikëqyrëse;
- » Përdorimi i dokumenteve e formateve të kolegjeve, si dhe marrëveshjet koordinuese;
- » Mënyrat e organizmit të një Kolegji si mbikëqyrje në grup dhe dhënia rekomandimeve të efektshme.

Në seminar u dha informacion mbi çështje praktike nga ekspertë e pjesëmarrës në kolegje, si dhe një rast studimor mbi organizmin e një kolegji mbikëqyrës.

Takimi i nëntë rajonal i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Më 29 maj në Budapest, Hungari, u zhvillua takimi i nëntë rajonal mes mbikëqyrësve të sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (*Insurance Supervision Initiative, CESEE ISI*). Takimi u organizua nga Banka Qendrore e Hungarisë (*Central Bank of Hungary, MNB*). Ky ishte takimi i radhës në kuadër të iniciativës *CESEE ISI*. Kjo inisiativë shërben si një forum për forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojës ndërmjet mbikëqyrësve të sigurimeve të vendeve të rajonit.

Në takim u diskutuan çështje të rëndësishme të lidhura me mbikëqyrjen e tregjeve të sigurimeve:

- » Zhvillimi i mbikëqyrjes së koordinuar (integruar);
- » Mbulimi i kompensimit për dëmet jo pasurore nga MTPL;
- » Mbikëqyrja e sjelljes në treg, përfshi ndërmjetësit në tregun e sigurimeve;
- » Çështje që lidhen me rregulloren e BE-së për dokumentat me informacionin kryesor për paketat e produkteve të investimeve me pakicë dhe bazuar në sigurime.

Tema e “mbikëqyrjes së koordinuar” u prezantua dhe moderua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Interesi për diskutimin e zhvillimit të mbikëqyrjes së koordinuar është rrjedhojë e krijimit të grupeve financiare në tregjet financiare shqiptare, si dhe e rritjes së shkallës së ndërthurjes së institucioneve financiare në vend. Mbikëqyrja e koordinuar efektive është gjithashtu një çështje në diskutim edhe në tregje të huaja, dhe ende nuk ka një model apo praktikë universale të konsoliduar.

Nga diskutimet rezultoi se është mjaft e rëndësishme të diskutohet mbi mbikëqyrjen e koordinuar për shkak të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet tregjeve financiare, veçanërisht ndërmjet sektorit bankar dhe veprimtarive të tjera financiare të rregulluara ose jo. Zhvillimi i mbikëqyrjes së koordinuar konsiderohet i rëndësishëm sepse përkufizimi i konglomeratit financiar nuk përfshin çdo rrezik që shfaqet, pra nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, mbikëqyrja e koordinuar shkon përtej aktivitetit të kolegjeve të mbikëqyrësve, që trajtojnë çështjet e grupeve financiare.

Në rastin e mbikëqyrjes së koordinuar është e rëndësishme që ndërmjet rregullatorëve të orientohet puna drejt një metodologjie të ngjashme dhe të realizohet edukim reciprok dhe pikëpamje e konsoliduar për rreziqet. Pika e nisjes për mbikëqyrjen e konsoliduar duhet të jetë identifikimi i strukturave komplekse dhe integriteti i tregut.

LAJMET NGA RAJONI

ESTONI

www.xprimm.com

Bordi Kombëtar i Statistikave të Estonisë njoftoi se vlera e primeve të shkruara bruto, në tremujorin e parë të vitit 2015 arriti një total prej 87.24 milionë euro duke u rritur me 4% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara bruto u rrit me rreth 1.29 milionë euro në vlerë absolute, duke arritur në 51.06 milionë euro.

Në segmentin e Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto u ul me 1.10% në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar, duke arritur në 9.80 milionë euro nga të cilat 7.10 milionë euro u raportuan në sigurimin e Jetës në produktet e lidhura me investimet.

Në segmentin e Jo-Jetës, vendin kryesor në primet e shkruara bruto e zuri sigurimi Kasko i mjeteve motorike (26.33% e totalit të primeve të shkruara bruto), sigurimi i pronës (20.40%) dhe MTPL (18.88%).

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, primet e shkruara bruto në tremujorin e parë të vitit 2015 kapën vlerën 17.06 milionë euro, krahasuar me vlerën 15.63 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në sigurimin e Jo-Jetës vlera e primeve të shkruara bruto shënoi 14.39 milionë euro ose 10.52% më shumë sesa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Këto prime zënë 84.32% të primeve të shkruara bruto të tregut në total. Në segmentin Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto u rrit me 2.21% duke arritur vlerën 2.68 milionë euro.

Në Malin e Zi kanë qenë aktive 11 kompani sigurimi, 6 sigurues Jete dhe 5 sigurues Jo-Jete.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, vlera e primeve të shkruara bruto, në tremujorin e parë të vitit 2015 arriti një total prej 18.04 milionë euro, afërsisht në të njëjtën vlerë me tremujorin e parë të vitit 2014. Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit në Kosovë arriti një total prej 8.98 milionë euro.

Ndër klasat e ndryshme të Jo-Jetës, produktet e sigurimit motorik janë segmenti dominues i tregut kosovar të sigurimeve, ku vlera e primeve të shkruara bruto të tyre përbën 60.75% të totalit. Nga volumi total i sigurimeve motorike, produkti MTPL e brendshme u llogarit në rreth 48.84% të totalit ose 8.81 milionë euro, ndërkohë që Policat Kufitare zunë afërsisht 11.91% të totalit.

Në tremujorin e parë të vitit 2015, shoqëritë e sigurimit në Kosovë nënshkruan rreth 200,620 kontrata sigurimesh, nga të cilat vetëm 70,020 ishin për produktet e sigurimit motorik, MTPL brendshme, dhe rreth 75,030 kontrata të Policave Kufitare, duke shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, sigurimet vullnetare arritën në 39.25% të totalit të tregut nga 36.54% që ishte kjo shifër në tremujorin e parë të vitit 2014.

KROACI

www.xprimm.com

Byroja Kroate e Sigurimeve njoftoi se vlera e primeve të shkruara bruto nga siguruesit kroatë, në tremujorin e parë të vitit 2015, arriti një total prej 2.54 miliardë HRK (Kruna, monedha vendase) ose rreth 332.34 milionë euro, duke u rritur me 3.76% në krahasim me vitin e kaluar. Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit arriti një total prej 1.06 miliardë HRK, ose 1.22% më pak se sa vitin e kaluar.

Në segmentin Jo-Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto u ul me 3.77% duke arritur në 1.72 miliardë HRK, ndërsa në segmentin e Jetës siguruesit raportuan një vlerë prej 820.28 milionë HRK të primeve të shkruara bruto.

Sipas statistikave të raportuara, në fund të muajit mars të këtij viti, në treg kishte 25 sigurues aktivë.